

Në bazë të nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit për shërbimin gjyqësor (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.43/14) nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.167/15), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18 – 5474/2 e datës 30.09.2020,

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
publikon
SHPLLJE PUBLIKE NUMËR 1/2020
për punësim të 3 (tre) personave për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim

1. Mjeshtër i përgjithshëm – 1 (një) realizues

Kushtet e posaçme:

- së paku arsim të mesëm profesional, me ose pa përvojë pune

Orari javor i punës është 40 orë;

Orari ditor i punës është 8 orë, prej ora 07,30 deri në ora 15,30;

Rroga neto në vlerë: 16.792,00 denarë

2. Mirëmbajtës të higjienës - 2 (dy) realizues

Kushtet e posaçme:

Arsimim të mesëm ose fillor të kryer, me ose pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë;

Orari ditor i punës është 8 orë, prej ora 13,00 deri në ora 21,00;

Neto pagesa fillestare: 14.932,00 denarë

Krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë, kandidatët duhet t'i përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parapara në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për shërbimin gjyqësor:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët obligohen që të parashtrojnë lutje për punësim dhe dëshmi për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter.

Lutja, krahas dëshmimeve, duhet të përmbajë, emër dhe mbiemër të kandidatit të vërtetuara me dëshmi për identifikim personal, banim, gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e-mail adresë dhe telefon për kontakt.

Afati për parashtrimin e lutjes është 8 (tetë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në gazetata ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Lutjen së bashku me dëshmitë, kandidatët obligohen që t'i parashtrojnë drejtpëdrejtë në sportelin e pranimit të gjykatës, gjatë orarit të punës ose në adresë postare:

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT

Bul. Krste Misirkov nr.8 Shkup
(me shenjë për Shpallje publike numër - 1/20)

Lutjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota, të parregulluara dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afatin e caktuar në nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune.